



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**AC-I-22-0515**

**Në ankesën e**

***Paditësja/Ankuesja***

**D D Kraljevë, Republika e Serbisë, e përfaqësuar nga **Projekti për Ndhimë Juridike falas, Graçanicë****

**Kundër**

***E paditura***

**NSH N.H "Drita"(në likuidim) e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë****

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditëses të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-0795 të datës 25 gusht 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 05 tetor 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditëses refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-0795 i datës 25 gusht 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me datë 03 qershor 2013, paditësja për mes postës e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI089-0092 të datës 21 maj 2013 me të cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për pagesën e pagave të papaguara për periudhën nga viti 1999 e deri në vitin 2006 në shumë prej 14.760,00 euro nga NSH N.H. "Drita", me arsyetimin se paditësja e ka paraqitur kërkesën me datë 04 qershor 2007, që është jashtë afatit për paraqitjen e kërkesës, si dhe me arsyetimin tjetër se kërkesa për paga ishte parashkruar. Paditësja në ankesë pohon se vendimi i ankimuar është i padrejtë dhe i pa mbështetur në ligj. Ajo pohon se ishte punëtore e NSH-së dhe se ajo ka të drejtë në këto paga të pa paguara nga NSH-ja. Tutje ajo pohon se ndjehet e diskriminuar, pasi që pohon se për shkak të rrethanave të sigurisë, i është dashtë në qershor të vitit 1999 ta lëshoj Kosovën, dhe pohon se ishte e detyruar të largohet nga puna pa vullnetin e saj. Bashkë me ankesë ka dorëzuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, Autorizimin e Avokatit, një dëftesë pagesë, dhe një kërkesë për lirim nga taksa gjyqësore.

Me datë 26 shtator 2014, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen në ankesë. AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja po ashtu pohon se kërkesa e paditëses për paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. AKP-ja pohon se paditësja ka dështuar të paraqesë në ankesën e tij se cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se paditësja ka dështuar të dorëzoi prova sa i për këtë kërkesës për pagesën e pagave të pretenduara ndaj NSH-së. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 30 tetor 2014, paditësja e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në mbrojtjen në ankesë të AKP-së. Në këtë parashtresë paditësja i kundërshton pretendimet e AKP-së se kërkesa është parashkruar, ndërsa vazhdon ti përsërit pretendimet e veta të cekura në ankesë.

Me datë 02 dhjetor 2014, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS kundërpërgjigjen në të cilën ajo i përsëritë pretendimet e veta të cekura në mbrojtje në ankesë.

Me datë 25 gusht 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-0795, ankesën e paditëses e refuzon si të pabazuar dhe vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësja nuk ka sjell prova për të vërtetuar se e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës duke dorëzuar ndonjë padi në gjykatën kompetente, si dhe nuk ka dorëzuar prova se ajo ka ofruar shërbime pune në NSH në periudhën në të cilat ajo i kërkon pagat e pretenduara ndaj NSH-së. Pastaj paditësja nuk ka dorëzuar prova për borxhin e pretenduar, si dhe prova për mënyrën e përlogaritjes së shumës së pretenduar në emër të pagave ndaj NSH-së. Barra e provës në bazë të nenit 42.2 të LDHP-së dhe nenit 7 të LPK-së bie mbi paditësen ajo ka dështuar ta mbështesë kërkesën e saj me prova, prandaj ankesa e saj është refuzuar si e pa bazuar dhe është vërtetuar vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 14 shtator 2022, paditësja përmes postës e dërgon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimi të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-13-0795 të datës 25 gusht 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar, ose të anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim. Për më tepër në ankesë paditësja ka pohuar se Aktgjykimi i ankimuar ka të meta të shumta për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet, e posaçërisht dispozitiv i Aktgjykimit është në kundërshtim me arsyet e dhëna në Aktgjykim, ose nuk ka fare arsye për faktet vendimtare. Tutje paditësja pretendon se Shkalla e I-rë ka qenë dashur ta anuloj vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit e jo të paraqes arsye kontradiktore për faktet vendimtare të kësaj çështje kontestimore. Arsyet e refuzimit të kërkesës janë të pa qarta dhe kontradiktore dhe rrjedhimisht për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike është e shkelur edhe e drejta materiale. Tutje paditësi pohon se Shkalla e I-rë nuk i ka marrë për bazë dispozitat materiale nga neni 221 deri 225 të Ligjit të Punës së Bashkuar, duke pohuar se e paditura ka qenë e detyruar të bëjë pagesën e pagave minimum tri vite mbrapa duke llogaritur nga momenti i fillimit të procedurës së likuidimit me datë 22.02.2007. Paditësja në ankesë

konsideron se me Aktgjykimin e ankimuar janë shkelur të drejtat e saj të përcaktuara me nenin 24 paragrafi 2 të Kushtetutës dhe me nenin 1 protokollin 1 të Konventës Evropiane për të Drejta dhe Liri të Njeriut. Tutje ajo pohon se konstatimet e Autoritetit e Likuidimit janë të gabuara dhe kontradiktore dhe rrjedhimisht gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale. Në ankesë paditësja i referohet edhe disa rasteve nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Me datë 04 nëntor 2022, AKP-ja e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së ankuesit. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se ajo e mbështet në tërësi Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS, ndërsa i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit si të pabazuara. AKP-ja në mbrojtjen në ankesë pohon se nuk do t'i përsërisë argumentet edhe më herët gjatë mbrojtjes në padi, pasi që kjo do të jetë e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Andaj nga këto arsye AKP-ja kërkon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e paditëses refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjorë, andaj duhet vërtetuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja me datë 04 qershor 2007 , e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit një kërkesë për kompensim e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 1999 e deri në muajin prill 2006 në shumë prej 14.760,00 euro, Kjo kërkesë është refuzuar si të pa vlefshme nga Autoriteti i Likuidimit se kërkesa

është dorëzuar jashtë afatit të paraparë, dhe po ashtu me arsyetimin tjetër se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja me ankesën e saj të dorëzuar në DHPGJS-ë me datë 03 qershor 2013, e cila ishte paraqitur kundër vendimit refuzues të Autoritetit të Likuidimit, i ka kundërshtuar konstatimet e dhëna të Autoritetit të Likuidimit dhe pretendon se NSH-ja asaj i ka mbetur borxh në emër të pagave në shumë prej 14.760,00 euro si paga të pa paguara, nga NSH-ja e cila ka shkuar në likuidim me datë 22 shkurt 2007.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se paditësja nuk ka sjell prova me të cilat do të vërtetonte se e ajo ka punuar për NSH-në në periudhën e cekur, mirëpo nuk e mbështet konstatimin e Autoritetit të Likuidimit dhe as të shkallës së I-rë se kërkesa tërësisht është parashkruar. Marrë parasysh faktin se kërkesa tek Autoriteti i Likuidimit është dorëzuar me datë 04 qershor 2007, atë herë dele që pagat nga muaji qershor 2004 e deri në prill 2006, nuk mund të konsiderohen si të parashkruara, pasi që ende nuk kanë kaluar tri vite të afatit të parashkrimit, mirëpo pagat tjera te periudhës tjetër më herët janë parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja me parashtresën e saj të datës 06 dhjetor 2013, ka sjell Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, Autorizimin e Avokatit, një dëftesë pagesë, dhe një kërkesë për lirim nga taksa gjyqësore, dhe asnjë dëshmi tjetër në mbështetje të kërkesës për paga.

Paditësja nuk ka sjellë ndonjë dëshmi që vërteton se ajo ka punuar prej vitit 1999 e deri muajin prill 2006, në të cilën periudhë ajo i kërkon pagat e pretenduara ndaj NSH-së.

Për më tepër Kolegji i Apelit vëren se paditësja në ankesën e saj vetë ka pohuar se pas qershorit të vitit 1999 për shkaqe sigurie asaj i është dashtë të largohet nga Kosova. Rrjedhimisht mund të konstatohet se paditësja pas qershorit të vitit 1999 ajo nuk ka ofruar asnjë shërbim pune në NSH.

Prandaj siç ka vendosur Kolegji i Apelit në jurisprudencën e tij të deri tanishme në disa raste (AC-I-15-0294, AC-I-16-0189, AC-I-16-0286), në rastin kur punëtori nuk ofron shërbime pune për NSH-në, ai nuk ka as bazë ligjore të kërkoj paga prej NSH-së, për punën që nuk e ka kryer.

Prandaj për këto baza ligjore, ankesa e paditëses duhet të refuzohet si e pa bazuar pasi që ajo nuk e ka mbështetur ankesën e saj me prova të duhura dhe barra e saj për ta mbështetur ankesën në bazë të nenit 42.2 të LDHP-së dhe nenit 7 të LPK-së, bie mbi paditësen.

Kolegji i Apelit nuk i pranon si të bazuara pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave procedurale, për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të gjendjes faktike, pasi që nuk janë të faktuara e aq më pak të argumentuara.

Prandaj nga këto arsye, rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar nuk mund të ndryshohet, andaj ankesa e paditëses refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

**Taksat gjyqësore:**

Në bazë të kërkesës së ankuseses për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore të dorëzuar në DHPGJS, me datë 03 tetor 2022, dhe provave mbështetëse të saj, ankuesja lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore për procedurën ankimore.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 05 tetor 2023.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtari Kryesues \_\_\_\_\_